



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI PENAL

Nr. 61007-00211-00-2021 i Regj. Themeltar
Nr. 00-2021-243 i Vendimit

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

Ilir Panda	Kryesues
Ervin Pupe	Anetar
Sokol Sadushi	Anetar

Në dhomën e këshillimit të datës 02/04/2021 mori në shqyrtim çështjen penale që i përket:

KËRKUES: MIMOZA MARGJEKA

AKUZA:

Zevendesimin e masës së sigurimit

BAZA LIGJORE: Neni 260/2 i K.Pr.Penale

KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 433 të Kodit të Procedurës Penale,

VËREN

Rrethanat e çështjes

Nga shqyrtimi gjyqësor ka rezultuar se Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, ka regjistruar në datën 09.07.2020, procedimin penal nr. 186, të vitit 2020. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, më datë 03.08.2020, ka shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale emrat e të hetuarve Nejton Bali, Klaudjo Zhilla dhe Skënder Demiraj për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale të "Korrupsionit aktiv të gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë", parashikuar nga nenet 319 e 25 të Kodit Penal, ndërsa për të hetuarit Arben Cara dhe Mimoza Margjeka për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale "Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë" të parashikuar nga nenet 319/ç e 25 i Kodit Penal.

Me kërkesë të Prokurorisë së Posaçme, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr.92, datë 5.09.2020, vendosi të caktojë masën e sigurimit me karakter shtrëngues "arrest në shtëpi" ndaj personit nën hetim Mimoza Margjeka Me vendimin nr.94, datë 12.09.2020, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe

Krimin e Organizuar ka vendosur vazhdimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi” për shtetasen Mimoza Margjeka.

Me ankimin e personave nën hetim, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr.29, datë 01.10.2020, ka vendosur miratimin e vendimit nr.92, datë 05.09.2020, dhe nr.94, datë 12.09.2020, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, pas njohjes me informacionin e prokurorit mbi hetimet e kryera dhe nevojat e sigurimit, ka vendosur, me vendimin nr.403, datë 24.11.2020, zëvendësimin e masës së sigurimit nga ajo e “arrestit në shtëpi”, për të hetuarën Mimoza Margjeka me atë të “Detyrimit për tu paraqitur në policinë gjyqësore”.

Mbështetur në ankimin e prokurorit, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr.221, datë 17.12.2020, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr.403, datë 24.11.2020, të Gjykatës së Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për shtetasen Mimoza Margjeka duke ricaktuar ndaj saj masën e sigurimit “arrest në shtëpi”.

Personi nën hetim Mimoza Margjeka ka paraqitur më datë 23.12.2020 kërkesë me objekt zëvendësimin e masës së sigurimit "Arrest në shtëpi", procedimin e saj në gjendje të lirë ose me një masë sigurimi më të butë siç është “Detyrimi për tu paraqitur në policingë gjyqësore”

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. 452, datë 24.12.2020, (objekt ankimi), ka vendosur:

“Rrëzimin si të pabazuar të kërkesës së kërkueses Mimoza Margjeka...”

Gjykata ka arsyetuar se në analizë të parashikimeve të nenit 260/2 të Kodit të Procedurës Penale, ndaj kërkueses/të hetuarës në raport me vendimmarrjen nr.92, datë 05.09.2020, të kësaj gjykate, nuk ka ndryshuar rëndësia e faktit për të cilin ajo është hetuar dhe as janë mbledhur në vijim të hetimit prova shfajësuese për të. Në këto kushte, pretendimet dhe provat e paraqitura nga kërkuësja në këtë gjykim nuk përbëjnë shkak të ri që ndikon në zbutjen e nevojave të sigurimit për të hetuarën, pasi ato janë marrë në shqyrtim nga kjo gjykatë kur ka vlerësuar zëvendësimin e masën nga “Detyrimi për tu paraqitur në policinë gjyqësore” në atë të “arrestit në shtëpi”.

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim personi nën hetim Mimoza Margjeka, e cila ka pretenduar ndryshimin e vendimit, procedimin e saj në gjendje të lirë ose me një masë sigurimi më të butë siç është “Detyrimi për tu paraqitur në policinë gjyqësore”

Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. 12, datë 22.01.2021, ka vendosur:

“Miratimin e vendimit nr. 452, datë 24/12/2020 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.”

Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka lënë në fuqi vendim e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me të njëjtën linjë arsyetimi.

Kundër vendimit nr. 12, datë 22.01.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ka paraqitur rekurs, më datë 05.02.2021, Mimoza Margjeka, duke pretenduar të njëjtat shkaqe si në ankim, ndryshimin e vendimeve dhe zëvendësimin e masës së sigurimit duke e lënë personin nën hetim në gjendje të lirë ose me një masë sigurimi më të butë siç është “Detyrimi për tu paraqitur në policinë gjyqësore ose ndonjë masë tjetër më e butë.

Personi nën hetim në rekurs ka pretenduar ndër të tjera se:

- Organi procedues e mbështet dyshimin e arsyeshëm vetëm në përgjimet telefonike të personave të tretë mes tyre, të cilat i quan prova. Përgjimet telefonike janë indicie që duhet të çojnë tek prova që në rastin në shqyrtim nuk ekziston.

- Nuk ka asnjë rast megjithëse në vëzhgim të vazhdueshëm dhe përgjim telefonik të vazhdueshëm të jenë shkëmbyer me Arben Cara biseda për ndërhyrje tek personin nën hetim Mimoza Margjeka dhe as një veprim kompromentues për dhënie parash.

- Në thelb të ankimit janë kushtet dhe nevojat e sigurimit të cilat janë të natyrës familjare dhe të shëndetit në përgjithësi, qoftë ai psikologjik por edhe fizik.

- Nga akti i vlerësimit psikologjik ka rezultuar se gjithë kjo periudhë ka qenë e vështirë për Agnesën ,

vajzën e vogël të personit nën hetim Mimoza Margjeka dhe shtetasit Arben Cara dhe ka sjellë pasoja në jetën e tyre.

- Nuk ekziston rreziku që personi të largohet, kjo pasi personi personi nën hetim Mimoza Margjeka ka qenë për një periudhë prej 24 ditësh me masën e sigurimit "Detyrim për tu paraqitur pranë policisë gjyqësore" dhe në asnjë rast nuk ka tentuar të shmangë procedimin apo të largohet.
- Të gjitha provat të cilat mund të merreshin në lidhje me hetimin e kësaj çështjeje në fazën e hetimeve paraprake dhe që nuk mund të përsëriten janë marrë nga ana e organit procedues dhe nuk ka asnjë mundësi që personi nën hetim të ketë mundësi efektive për ti prishur apo zhdukur ato.
- Personin nën hetim ndodhet në një situatë ku e ka të pamundur të rikthehet në detyrë nëse masa e sigurimit nuk ndryshon në një masë më të lehtë
- Masa e sigurimit arrest në shtëpi është e papërshtatshme, pasi nuk i përgjigjet rrezikshmërisë së personit nën hetim Mimoza Margjeka, i cili është një person që ka punuar në organet e drejtësisë, më pas gjyqtare e që nuk ka asnjë masë vërejtje nga KLGJ gjatë ushtrimit të detyrës dhe më kryesorja ka përgjegjësinë e një prindi me një fëmijë 4 vjeç.
- Nuk vërtetohet ekzistenca e rrethanave rënduese në raport me veprën penale dhe autorin e dyshuar.
- Ndaj shtetases Mimoza Margjeka nuk mund të ketë një masë siguri edhe për shkak të nevojave të vajzës së mitur, e cila de jure dhe de facto është në masë siguri, pasi si nëna ashtu dhe babai i saj janë në masë siguri arrest në shtëpi, duke bërë të pamundur që fëmija 4 vjeçar të shkojë në kopësht apo të zhvillojë aktivitete të përshtatshme për moshën e saj. Për të miturën është krijuar artificialisht në ndalim i paligjshëm në kundërshtim dhe me disa praktika të GJEDNJ-së".

Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

15. Kolegji Penali Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji) konstaton se rekursi është paraqitur brenda afatit të parashikuar në nenin 435 të Kodit të Procedurës Penale. Gjithashtu, rekursi i është komunikuar Prokurorisë së Posaçmepër Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

16. Neni 432 i Kodit të Procedurës Penale, në pikën 1 të tij, parashikon se rekursi kundër vendimit të gjykatës së apelit mund të bëhet kur nuk është respektuar ose është zbatuar gabim ligji material ose procedural i cili është me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore; kur nuk është respektuar ose është zbatuar gabim ligji procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave; ose kur vendimi i ankimuar vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

17. Kolegji vlerëson se rekursi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale, të cilat do ta bënin të cenueshëm vendimin nr. 12, datë 22.01.2021, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

18. Kolegji vlerëson se në rastin objekt gjykimi pjesa e pretendimeve që ngre çështje të vlerësimit të provave del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë. Në të gjitha rastet kur rekursi nuk i përmbahet shkaqeve të përcaktuara nga neni 432/1 i Kodit të Procedurës penale, Kolegji Penal vendos mospranimin e rekursit. Qëndrimi që mban Kolegji për rastin në shqyrtim, bazohet edhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që referon në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas të cilave shkaqet e parashtruara në rekurs që rezultojnë haptazi të pabazuara vlerësohen si të papranueshme për pranimin e rekursit.

19. Kolegji vlerëson se janë zbatuar drejtë kërkesat e nenit 260 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me rrëzimin e kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit. Neni 260/2 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se: *"Kur nevojat e sigurimit zbuten ose kur masa e zbatuar nuk i përgjigjet më rëndësisë së faktit ose dënimit që mund të caktohet, gjykata e zëvendëson masën me një tjetër më të lehtë.*

20. Për sa më sipër, rezulton se gjykata mund të vendosë zëvendësimin e masës së sigurimit me një më të butë në dy raste:

- Së pari, kur nevojat e sigurimit zbuten;

- *Së dyti*, kur masa e sigurimit e zbatuar nuk i përgjigjet më rëndësisë së faktit ose dënimit që mund të caktohet.

21. Kolegji vlerëson se mjafton të provohet ekzistenca e një nga shkaqeve të mësipërme dhe gjykata vendos të zëvendësojë masën e sigurimit me një më të butë. Në çështjen objekt gjykimi në lidhje me nevojën për zëvendësimin e masës së sigurimit gjykatat e faktit kanë argumentuar mjaftueshëm faktin se nevojat e sigurimit nuk janë zbutur. Provat e depozituar nga kërkuesi janë marrë në shqyrtim dhe në gjykimet e mëparshme nga gjykata dhe në këto kushte ato nuk konsiderohen si prova të reja që diktojnë zëvendësimin e masës së sigurimit.

22. Kolegji evidenton se gjykatat e faktit kanë zhvilluar një proces të rregullt ligjor, duke garantuar zhvillimin e një hetimi të plotë e të gjithanshëm të nevojave zëvendësimin e masës së sigurimit. Gjykata e shkallës së parë edhe gjykata e apelit kanë bërë një analizë tërësore dhe objektive të provave të ndodhura në fashikullin e hetimit të paraqitur nga organi i akuzës. Gjykatat i kanë çmuar ato në bazë të bindjes së tyre të brendshme, të formuar nga shqyrtimi në tërësinë e rrethanave të çështjes në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi si dhe duke dhënë edhe arsyet ligjore përse është lënë në fuqi vendimi i gjykatës së shkallës së parë.

23. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se rekursi i paraqitur në Gjykatën e Lartë kundër vendimit nr. 12, datë 22.01.2021, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nuk përmban ndonjë prej shkaqeve të parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale dhe për rrjedhojë nuk mund të pranohet.

PËR KËTO ARSYE

Pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarit Ilir Panda dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VENDOSI

Mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkueses Mimoza Margjeka, kundër vendimit me nr. 12, datë 22.01.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Tiranë, më 02/04/2021

Anetar:

Ervin Pupe

Anetar:

Sokol Sadushi

Kryesues:

Ilir Panda